



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 43/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesit të autorizuar të palës ankuese av. _____ dhe palës ankuese _____, dhe përmbaruesit privat z. _____, dhe pas seancës këshillimore, me datën 19.11.2021, mori si në vijim:

V E N D I M

REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-43/2021, e datës 15.10.2021, si dhe ankesa e përbashkët e paraqitur nga z. _____ dhe z. _____, e datës 13.10.2021, si të paafatshme.

A R S Y E T I M

Me datën 04.10.2021, përkatësisht me dt 13.10.2021, pala ankuese z. _____ respektivisht edhe z. _____, i cili i është bashkangjitur ankesës fillestare, kanë paraqitur ankesë të përbashkët në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. _____ i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në _____. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat z. _____ ka kryer shkelje të dispozitës së nenit 5 par 3 dhe 4 të LLP-së, nenit 10 par 1 dhe 2, të LPP-së, dhe nenit 17 të LPP-së lidhur me nenin 31 par 1 dhe 1 të LPP-së. Pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat z. _____ ka ndërruar debitorin sepse specifikisht në titullin përmbarimor – Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, C. nr.201/05, të dt 29.03.2013, debitor ka qenë z. _____, ndërsa përmbaruesi privat z. _____ ka ndërmarr veprime duke tjetërsuar pronën e birit të debitorit, z. _____. Derisa propozimi për përmbarim ka qenë ndërmarrja e veprimeve në realizimin e dobisë në të holla, përmbaruesi privat ka tejkaluar kompetencat e tij dhe pa rregullim dhe ndryshim të propozimit për përmbarim, pa qenë paluajtshmëria me barrë (hipotekë) ka

ndërmarr veprime ndaj personit të tretë dhe ndaj një prone e cila as që ka qenë objekt i pëmbarrimit. Pala ankuese thekson se pëmbarruesi privat pa e informuar palën debitore ka ndërmarr veprime ndaj një personi që nuk ka legjitimitet real pasiv, ndërsa as debitori real ndaj të cilit është iniciuar procedura pëmbarrimore nuk ka mundur të mbroj të drejtën e tij, respektivisht nuk i është dhënë mundësia që të disponojë me të drejtat e tij duke mos qenë i informuar për veprimet e ndërmarrta pëmbarrimore.

Me datën 15.10.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Pëmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj pëmbarruesit private z. [Emri i palës], organ pëmbarrues, i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me veprimet pëmbarrimore në lëndën pëmbarrimore P. nr 226/2017.

Pëmbarruesi privat z. Afet Mjeku në përgjigjen e tij me shkrim thekson që pëmbarrimi është lejuar me urdhrin P. nr 226/17, për ekzekutimin në të holla dhe sende të luajtshme, i cili urdhër i është dorëzuar personalisht nga ana e pëmbarruesit privat debitorit [Emri i palës], i cili ka pranuar shkresat por ka refuzuar nënshkrimin. Ndaj urdhrin për lejimin e pëmbarrimit është paraqitur prapësim, por i njëjti është refuzuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën. Meqenëse pala debitore nuk ka pasur mjete financiare në llogari bankare, kreditori me parashtrësën e datës 30.05.2018, ka kërkuar që procedura pëmbarrimore të vazhdohet në sende të paluajtshme ndaj debitorit, konform nenit 10 par 8 të LPP-së. Pala debitore duke qenë në dijeni për zbatimin e procedurës pëmbarrimore ndaj tij, përmes kontratës mbi dhuratën ka bartur paluajtshmërinë P-72217092-02476-0 ZK Ferizaj, në sipërfaqe prej 347 m2, dhe si rezultat, pala kreditore ka parashtruar kërkesë të re me dt 20.11.2019 me të cilën ka kërkuar që procedura e pëmbarrimit të vazhdohet kundër të birit të tij, përkatësisht z. [Emri i palës], në pajtim me nenin 205 pika 1 dhe 2-të LPP-së. Rrjedhimisht, pëmbarruesi privat duke vendosur lidhur me parashtrësën e kreditorit për vazhdimin e procedurës së pëmbarrimit në paluajtshmëri ndaj debitorit z. [Emri i palës] me urdhrin e dt 21.11.2018 ka vazhduar procedurën e pëmbarrimit, i cili urdhër është tentuar t'i dorëzohet debitorëve z. [Emri i palës] dhe z. [Emri i palës] por nga ana e Postës është konstatuar se të njëjtit kanë udhëtuar jashtë vendi. Pëmbarruesi privat thekson se është provuar që urdhëri t'i dorëzohet personalisht në shtëpinë e tyre por në lokalin i cili gjendet në rrugën "Rexhep Bislimi" nr 28 në Ferizaj janë njoftuar nga z. [Emri i palës] se palët debitore z. Nebih Cocaj dhe z. [Emri i palës] gjenden në Ulqinë. Gjykata Themelore në Ferizaj me aktvendimin PPP. Nr 180/18 dt 21.12.2018 ka aprovuar kërkesën e palës kreditore ashtu që palës debitore i ka caktuar përfaqësues të përkohshëm përkatësisht Av. Skender Jetishi nga Ferizaji, të cilit i janë dorëzuar të gjitha shkresat e lëndës. Pëmbarruesi privat thekon se me dt 28.02.2019 është bërë dalja në teren për vlerësimin e paluajtshmërive dhe ekspertëve përkatës iu janë dhënë detyrat e vlerësimt. Pas pranimit të ekspertizave, me dt 17.04.2019, është caktuar ankanti i parë publik për shitjen e paluajtshmërisë, ndërsa ankanti i dytë përmes konkluzionit është caktuar për dt 16.05.2019. Pas disa shtyrjeve, ankanti i dytë publik është mbajtur me dt 17.07.2019, dhe me propozim të kreditorit, të njëjtit i është dorëzuar paluajtshmëria duke kaluar në pronësi të tij pajujtshmërinë në fjalë. Konkluzioni dhe urdhri për dorëzim dhe kalim në pronësi të paluajtshmërisë iu është dorëzuar palëve dhe meqenëse asnjëra palë nuk ka paraqitur ankesë, me dt 17.06.2020 urdhëri për dorëzimin e paluajtshmërisë është pajisur me klauzolën e formës së prerë.

Me datën 19.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Pëmbarrimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, përfaqësuesi i autorizuar i palës

ankuese Av. Ilir Rashiti dhe pala ankuese z.

si dhe përmbaruesi privat z.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e Raportit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se mbetet pranë tij. Po ashtu, përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese Av. dhe pala ankuese z.

kanë bërë eleborimin e ankesës së paraqitur me shkrim dhe kanë theksuar se qëndrojnë pranë atyre pretendimeve. Përmbaruesi privat z., gjithashtu ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e nrgitura ndaj tij për shkelje disiplinore dhe ka kërkuar refuzimin e ankesës.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se propozimi-ankesa për fillimin e procedurës disiplinore është i pasafatshëm.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson që neni 375 i LPP-së, shprehimisht përcakton që *“procedura disiplinore (ndaj përmbaruesit privat theksimi i shtuar) mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes.”* Kjo do të thotë se procedura disiplinore ndaj përmbaruesve privat më së voni mund të fillohet brenda një (1) viti nga dita e shkeljes së pretenduar disiplinore. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës disiplinore shfaqet më vonë, afati fillon të rrjedh nga ajo kohë. Në rastin në fjalë, përmbarimi është lejuar me urdhrin P.nr 226/17 dt 04.07.2017 sipas propozimit për përmbarim të kreditorit për realizimin e borxhit në shumën prej 40,000.00 euro. Me konkluzionin P. nr 226/17 dt 19.04.2019 cakton ankandin e dytë publik për tjetërsimin e parcelës P-72217092-02476-0 ZK Ferizaj, në sipërfaqe prej 347 m², e cila evidentohet në emër të z. ndërsa me urdhrin përmbarimor P. nr 226/17 dt 17.07.2019, përmbaruesi privat i dorëzon kreditorit z.

paluajtshmërinë e nxjerrur në ankand dhe rrjedhimisht me kërkesën e dt 17.06.2020 kërkon nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës që këtë paluajtshmëri ta bart tek pala kreditore. Rrjedhimisht, shkelja e pretenduar disiplinore i referohet urdhrin përmbarimor P. nr 226/17 dt 17.07.2019, me të cilin përmbaruesi privat i dorëzon kreditorit z. paluajtshmërinë e nxjerrur në ankand dhe kërkesës së dt 17.06.2020, me të cilën përmbaruesi privat kërkon nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës që këtë paluajtshmëri ta bart tek pala kreditore, dhe si të tilla, për këto pretendime për shkelje disiplinore nga ana e përmbaruesit privat z.

ka kaluar afati prej një (1) viti brenda të cilit mund të fillohej procedura disiplinore ndaj tij pranë Komisionit Disiplinor. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor është i kufizuar të jap vlerësimin e tij lidhur me meritat e ankesës.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 43/2021, datë 19.11.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

Washington County, Oregon, is a county in the state of Oregon. It is located in the northwestern part of the state, and is one of the most densely populated counties in the state. The county is home to the city of Medford, which is the largest city in the county. The county is also home to several other cities, including Ashland, Grants, and Klamath Falls. The county is known for its scenic beauty, and is a popular destination for tourists. The county is also known for its agriculture, and is a major producer of timber and dairy products. The county is a member of the Willamette Valley Council of Governments, and is part of the Willamette Valley Metropolitan Area. The county is also a member of the Oregon Department of Transportation, and is a major transportation hub for the region. The county is a member of the Oregon Department of Education, and is a major provider of education services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Health Services, and is a major provider of health services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Social Services, and is a major provider of social services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Justice, and is a major provider of justice services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Public Safety, and is a major provider of public safety services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Parks and Recreation, and is a major provider of parks and recreation services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Transportation, and is a major provider of transportation services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Education, and is a major provider of education services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Health Services, and is a major provider of health services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Social Services, and is a major provider of social services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Justice, and is a major provider of justice services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Public Safety, and is a major provider of public safety services to the region. The county is a member of the Oregon Department of Parks and Recreation, and is a major provider of parks and recreation services to the region.



Washington County, Oregon
 Seal of Washington County, Oregon